



Qendra për Arsim e Kosovës
Kosova Education Center

KEC



Rregullorja e shkollës “Mileniumi i Tretë”

Nr.	Rregulla	Shpagimi/Pasoja
1.	Çdo nxënës duhet të respektojë të gjithë personelin dhe nxënësit e shkollës.	Nxënësi që shan, ofendon, lëndon fizikisht të tjerët apo nuk u bindet udhëzimeve të arsimtarëve vetëm një herë, shënohet në regjistrin e vërejtjeve* dhe qëndron në shkollë deri në orën 17:00. Po ashtu në këto raste Këshilli i Mësimdhënësve, varësisht nga pesha e fajit vendos edhe për shpagime të tjera të mundshme.
2.	Secili nxënës gjatë orëve të mësimit nuk mund të dalë nga klasa pa lejen e daljes të cilën e merr nga mësimdhënësi. Mësimdhënësi ose çdo pjesëtar i stafit të shkollës që e sheh nxënësin në korridor dhe hapësirat jashtë klasës është i obliguar ta pyesë nxënësin, nëse e ka fletën e daljes. Në rast se nxënësi nuk e posedon fletën e daljes ose nuk është në vendin e lejuar nga mësimdhënësi, atëherë mësimdhënësi ose çdo pjesëtar i stafit të shkollës evidenton nxënësin në regjistrin e vërejtjeve dhe e dërgon atë në dhomën e takimeve deri në përfundim të orës.	Nxënësi, i cili tri herë gjatë orëve të mësimit nuk e ka fletën e daljes dhe shënohet tri herë në regjistrin e vërejtjeve* qëndron në shkollë deri në ora 17:00.
3.	Veshja e uniformës së shkollës është e obliguar në të gjitha hapësirat e shkollës.	Nxënësi, i cili nuk e ka uniformën të veshur në hapësirat e shkollës shënohet në regjistrin e vërejtjeve. Nëse nxënësi, gjatë orës së mësimit nuk e ka uniformën të veshur dhe të dukshme largohet nga ora e mësimit me fletën e daljes dhe nxënësi shkon në dhomën e takimeve deri në fund të orës. Mësimdhënësi shënon nxënësin në regjistrin e vërejtjeve*. Nëse nxënësi tri herë përsërit këtë

		thyerje të rregullës qëndron në shkollë deri në orën 17:00.
3.1	Nxënësi duhet ta ketë uniformën shkollore që në momentin kur hyn në transport të shkollës.	Nxënësi pa uniformë shkollore nuk lejohet të hyjë në transportin e shkollës.**
3.2	Nëse nxënësi vjen me transport alternativ, atëherë nxënësi është i obliguar ta ketë uniformën veshur para se të hyjë në hyrje të shkollës.	Nxënësi nuk mund të hyjë në hapësirat e shkollës.**
3.3	Uniforma e nxënësit duhet të jetë tërësisht e dukshme.	Nxënësi, i cili tri herë, gjatë orarit mësimor nuk e ka tërësisht të dukshme uniformën shënohet në regjistrin e vërejtjeve* dhe qëndron në shkollë deri në orën 17:00.
3.4	Nxënësit gjatë ditës së premtë kanë të drejtë të vishen sipas dëshirës, por të bazuar në kodin etik të veshjes.	Nxënësi i cili nuk e respekton kodin etik të veshjes shënohet në regjistrin e vërejtjeve* dhe do të duhet të qëndrojë në shkollë deri në orën 17:00 .
4.	Nuk lejohet përdorimi i pajisjeve elektronike gjatë orëve të rregullta mësimore, përveç me kërkesën e mësimdhënësit për zhvillimin e aktiviteteve mësimore.	Nxënësi, i cili përdor pajisje elektronike gjatë orëve të rregullta mësimore, pajisja i merret deri në fund të ditës dhe nxënësi shënohet edhe në regjistrin e vërejtjeve* Nëse i merret tri herë rresht, nxënësi qëndron në shkollë deri në orën 17:00.
4.1	Përdorimi i pajisjeve elektronike është i lejuar në këto raste: *Gjatë orëve të studimit vetëm për dëgjim muzike deri sa punon detyrat. *Gjatë pushimit të mëngjesit dhe drekës.	Në rast të keqpërdorimit të pajisjeve elektronike si për shembull: incizimi, argëtimi me lojëra, nxënësi shënohet në vërejtje dhe Këshilli i Mësimdhënësve cakton pasojën për rastin e keqpërdorimit.
5.	Ndalohet pirja dhe posedimi i duhanit apo çfarëdo mjeti narkotik gjatë orarit mësimor në hapësirat e shkollës dhe gjatë transportit.	Nëse nxënësi posedon apo konsumon duhan dhe ndonjë lëndë tjetër alkoolike apo narkotike, shënohet në regjistrin e vërejtjeve dhe Këshilli i Mësimdhënësve vendos për masat e mëtutjeshme.
6.	Çdo nxënës duhet të kujdeset për inventarin dhe pajisjet shkollore	Nxënësi i cili dëmton inventarin dhe pajisjet e shkollës shënohet në regjistrin e vërejtjeve* dhe qëndron në shkollë deri në orën 17:00. Po ashtu ai nxënës është i obliguar që të paguajë dëmin e shkaktuar brenda javës.

7.	Nxënësi duhet të respektojë orarin e ushqimit.	Nxënësi, i cili tri herë rresht nuk e respekton orarin e ushqimit të caktuar në fillim të vitit shkollor, shënohet në regjistrin e vërejtjeve* dhe duhet të qëndrojë në shkollë deri në orën 17:00.
7.1	Nxënësi duhet të ushqehet në sallën e ushqimit, në orarin e caktuar dhe jo brenda objektit shkollor. Nxënësit, të cilët marrin ushqim nga shtëpia gjithashtu ushqehen në hapësirën e veçantë, në sallën e ushqimit.	Nxënësi i cili nuk respekton rregullat për ushqimin tri herë shënohet në regjistrin e vërejtjeve* dhe duhet të qëndrojë në shkollë deri në orën 17:00.
7.2	Nxënësit nuk lejohen të porosisin ushqim nga jashtë.	Në rast të mosrespektimit të kësaj rregulle, nxënësi shënohet në regjistrin e vërejtjeve* dhe duhet të qëndrojë në shkollë deri në ora 17:00.
8.	Nxënësi duhet të jetë përgjegjës për mirëmbajtjen e pastërtisë në të gjitha hapësirat e shkollës (sidomos në fushën e sportit) dhe mirëmbajtjen e dollapëve si dhe respektimin e riciklimit të mbeturinave.	Nxënësi i cili hedh mbeturinat tri herë jashtë vendeve të caktuara shënohet në regjistrin e vërejtjeve* dhe qëndron në shkollë deri në orën 17:00. Gjatë kësaj kohe, është i obliguar që të pastrojë një hapësirë të caktuar të shkollës.
9.	Nxënësi duhet të kujdeset që të mos bëjë thyerje të vazhdueshme të rregullave dhe të përmirësojë sjelljen.	Nëse nxënësi shënohet tri herë në regjistrin e vërejtjeve, me të do të merret Këshilli i Mësimdhënësve, i cili do të bazohet në udhëzimin administrativ dhe ligjin për arsim dhe në konsultim me prindin dhe psikologun do të marrë vendimet e mëtutjeshme.

* Nxënësit që shënohen në regjistrin e vërejtjeve tri herë mund të mos marrin pjesë në aktivitete jashtëmësimore (ekskursione, teatro, kinema, vizita, etj.) varësisht nga vendimi i Këshillit të Mësimdhënësve. Nxënësve iu shqiptohen masa të tjera disiplinore të vendosura nga Këshilli të Mësimdhënësve, varësisht nga pesha e fajit.

Nxënësit që ka thyer njëherë nga rregullat e shkollës dhe duhet të qëndrojë deri në ora 17:00, i lajmërohet prindi nga kujdestari i klasës, i cili e informon për ditën e qëndrimit në shkollë.

Gjatë qëndrimit në shkollë, mësimdhënësit kujdestarë merren me organizimin e aktiviteteve dhe detyrave për nxënësit në fjalë.

Transportin e nxënësit për në shtëpi e merr përsipër prindi.

** Nëse nxënësi thyen rregullën për uniformë dy herë, herën e tretë kthehet në shtëpi dhe i lajmërohet prindi nga ana e kujdestarit. Për hapa të mëtutjeshëm vendos komisioni disiplinor.

Emri dhe mbiemri:

Nxënësi: _____

Prindi: _____

Kujdestari i klasës: _____

Nënshkrimi:

Komisioni disiplinor për miratimin e rregullave të shkollës:

Fatmir Fejziu _____

Shpetim Kastrati _____

Fitore Hoxha _____

Prishtinë, 29 gusht 2014